
DIREKTIVË E KËSHILLIT 2011/96/BE, DATA 30 NËNTOR 2011, "PËR SISTEMIN E PËRBASHKËT TATIMOR TË ZBATUESHËM NË RASTIN E SHOQËRIVE MËMË DHE DEGËVE NË SHTETE TË NDRYSHME ANËTARE"

(riformulim)

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 115 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projekt aktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian¹,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social²,

Duke vepruar në përputhje me një procedurë të veçantë legjislative,

Meqë:

1. Direktiva e Këshillit 90/435/KEE, datë 23 korrik 1990, "Për sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm në rastin e shoqërive mëmë dhe degëve në shtete të ndryshme anëtare"³ është ndryshuar disa herë në mënyrë thelbësore⁴. Meqë do të bëhen ndryshime të mëtejshme, kjo direktivë duhet të riformulohet për të qenë më e qartë.

2. Nisur nga vendimi i Gjykatës së Drejtësisë, datë 6 maj 2008, për çështjen C-133/06⁵, gjykohet i nevojshëm riformulimi i nënparagrafit të dytë të nenit 4, paragrafi 3, të Direktivës 90/435/KEE, me qëllim që të sqarohet se rregullat e përmendura në të janë miratuar nga Këshilli në përputhje me procedurën e parashikuar në Traktat. Veç kësaj është me vend që të përditësohen shtojcat e asaj direktive.

3. Objektivi i kësaj direktive është që dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit nga degët të shoqëritë të tyre mëmë, të përjashtohen nga tatimi në burim dhe të eliminohet tatimin e dyfishtë i këtyre të ardhurave në nivelin e shoqërisë mëmë.

4. Grupimi i shoqërive të shteteve të ndryshme anëtare, mund të jetë i nevojshëm për të krijuar brenda Bashkimit Evropian, kushte të ngjashme me ato të tregut të brendshëm dhe për të garantuar funksionimin efikas të këtij tregu të brendshëm. Këto operacione nuk duhen penguar nga kufizime, disavantazhe ose shtrembërime që lindin veçanërisht nga dispozitat tatimore të shteteve anëtare. Për rrjedhojë është e nevojshme që për këto grupime shoqërisht të shteteve të

ndryshme anëtare të parashikohen rregulla tatimore që janë asnjëherë nga pikëpamja e konkurrencës, në mënyrë që të lejohen sipërmarrjet të përshtatin kërkesat e tregut të brendshëm për të rritur produktivitetin e tyre dhe për të përmirësuar fuqinë konkurruese në nivel ndërkombëtar.

5. Ky grupim mund të sjellë formimin e grupeve të shoqërive mëmë dhe degëve.

6. Përpara hyrjes në fuqi të Direktivës 90/435/KEE, dispozitat tatimore që rregullojnë marrëdhënien midis shoqërive mëmë dhe degëve të shteteve të ndryshme anëtare varionin ndjeshëm nga njëri shtet anëtar në tjetrin dhe përgjithësisht kanë qenë më pak avantazhuese se ato të zbatuara për shoqëritë mëmë dhe degët në të njëjtin shtet anëtar. Në këtë mënyrë bashkëpunimi midis shoqërive të shteteve të ndryshme anëtare ka qenë i disavantazhuar krahasuar me bashkëpunimin midis shoqërive të të njëjtit shtet anëtar. Eliminimi i këtij disavantazhi duke futur një sistem të përbashkët u bë i nevojshëm në mënyrë që të lehtësohej grupimi i shoqërive në nivel Bashkimi Evropian.

7. Kur shoqëria mëmë me anë të lidhjes me degën e saj merr fitimet e shpërndara, shteti anëtar i shoqërisë mëmë ose duhet t'i shmanget tatimit të këtyre fitimeve ose duhet t'i tatonjë këto fitime duke autorizuar shoqërinë mëmë që të zbresë nga shuma e tatimit atë pjesë të tatimit të shoqërisë që është paguar nga dega e që lidhet me ato fitime.

8. Gjithashtu, për të garantuar paanësinë fiskale, është e nevojshme që fitimet që një degë shpërndan për shoqërinë e saj mëmë, të përjashtohen nga tatimi në burim.

9. Pagesa e shpërndarjeve të fitimit të selia e përhershme e një shoqërie mëmë dhe arkëtimi i kësaj pagese prej saj, duhet të trajtohet në të njëjtën mënyrë siç trajtohet po e njëjta pagesë mes degës dhe mëmës së saj. Këtu duhet të përfshihet situata ku një shoqëri mëmë dhe dega e saj janë në të njëjtin shtet anëtar dhe selia e përhershme është e vendosur në një shtet tjetër anëtar. Nga ana tjetër, rezulton që shtetet anëtare mund t'i trajtojnë në bazë të legjislacionit të tyre të brendshëm, por pa cenuar zbatimin e parimeve të traktatit, ato situata ku selia e përhershme dhe dega ndodhen në të njëjtin shtet anëtar.

10. Për trajtimin e selive të përhershme, mund të nevojitet që shtetet anëtare të vendosin kushtet dhe instrumentet ligjore për të mbrojtur të ardhurat tatimore kombëtare dhe për të shmangur anashkalimin e ligjeve kombëtare, në përputhje me parimet e traktatit dhe duke marrë parasysh rregullat tatimore të njohura ndërkombëtarisht.

11. Kur grupet e shoqërive janë të organizuara përmes zinxhirit të shoqërive dhe fitimet shpërndahen përmes zinxhirit të degëve të shoqëria mëmë, tatimi i dyfishtë duhet eliminuar përmes përjashtimit tatimor ose kreditimit të tatimit. Në rastin e kreditimit të tatimit, shoqëria mëmë duhet jetë në gjendje të zbresë çdo tatim të paguar nga çdo degë e saj në zinxhir, me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë.

12. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë detyrimin e shteteve anëtare për afatin kohor për transpozim në legjislacionin e brendshëm të direktivës së përcaktuar në pjesën B të shtojcës II,

MIRATON KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

1. Çdo shtet anëtar e zbaton këtë direktivë:

a) për shpërndarjet e fitimeve të shoqëritë e atij shteti anëtar, nga degë të tyre në shtete të tjera anëtare;

b) për shpërndarjet e fitimeve nga shoqëritë e atij shteti anëtar të shoqëritë e shteteve të tjera anëtare ku ato janë degë;

c) për shpërndarjet e fitimeve të marra nga selitë e përhershme, që ndodhen në atë shtet anëtar, të shoqërive të shteteve të tjera anëtare, që vijnë nga degët e tyre në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai ku ndodhet selia e përhershme;

d) për shpërndarjet e fitimeve nga shoqëritë e atij shteti anëtar të selitë e përhershme, që ndodhen në një tjetër shtet anëtar, të shoqërive të të njëjtit shtet anëtar të i cili ato janë degë.

2. Kjo direktivë nuk parandalon zbatimin e dispozitave vendase ose të atyre të parashikuara në marrëveshje, të cilat nevojiten për parandalimin e mashtrimit ose abuzimit.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) "shoqëri e një shteti anëtar" është çdo shoqëri që:

I. merr njërën nga format e renditura në shtojcën I, pjesa A;

II. sipas legjislacionit tatimor të një shteti anëtar, konsiderohet të jetë rezidente në atë shtet anëtar për qëllime tatimore dhe sipas kushteve të marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë të lidhur me një shtet të tretë, nuk konsiderohet se është rezidente për qëllime tatimore jashtë Bashkimit Evropian;

III. gjithashtu, i nënshtrohet njërit prej tatimeve të renditura në shtojcën I, pjesa B, pa mundësinë e të qenit e përjashtuar ose të një opsioni të tillë, ose i nënshtrohet çdo tatimi tjetër që mund të zëvendësohet me secilin nga ato tatime;

b) "seli e përhershme" është një vend fiks biznesi që ndodhet në një shtet anëtar, përmes të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht veprimtaria tregtare e shoqërisë së një tjetër shteti anëtar, për sa kohë që fitimet e atij vendi biznesi janë objekt tatimi në shtetin anëtar në të cilin ai ndodhet, me anë të marrëveshjes tatimore dypalëshe përkatëse, ose në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, me anë të legjislacionit kombëtar.

Neni 3

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj direktive:

a) statusi i shoqërisë mëmë i atribuohet:

I. të paktën një shoqërie të shtetit anëtar që përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 2 dhe që zotëron të paktën 10 % të kapitalit të një shoqërie të një tjetër shteti anëtar që përmbush të njëjtat kushte;

II. një shoqërie të një shteti anëtar, sipas po të njëjtave kushte, që zotëron të paktën 10 % të kapitalit të një shoqërie të njëjtës shtet anëtar, të zotëruar tërësisht ose pjesërisht nga një seli e përhershme e shoqërisë së mëparshme që ndodhet në një tjetër shtet anëtar;

b) "degë" është ajo shoqëri, kapitali i të cilës përfshin pjesën e zotëruar të përmendur në pikën "a".

2. Duke bërë përjashtim nga paragrafi 1, shtetet anëtare kanë mundësinë:

a) të zëvendësojnë, me anë të një marrëveshjeje dypalëshe, kriterin për zotërimin e kapitalit me atë për zotërimin e të drejtave të votës;

b) të mos e zbatojnë këtë direktivë për shoqëritë e atij shteti anëtar, që për një periudhë të pandërprerë prej të paktën 2 vjetësh nuk mbajnë në zotërim atë pjesë që i kualifikon ato si shoqëri mëmë, ose për ato të shoqërive të tyre në të cilat një shoqëri e një tjetër shteti anëtar nuk e zotëron këtë pjesë për një periudhë të pandërprerë prej të paktën 2 vjetësh.

Neni 4

1. Kur një shoqëri mëmë ose selia e saj e përhershme, me anë të lidhjes së shoqërisë mëmë me degën e saj, merr fitime të shpërndara, shteti anëtar i shoqërisë mëmë dhe shteti anëtar i selisë së saj të përhershme, me përjashtim të rasteve kur dega likuidohet, duhet ose:

a) të përjashtohet nga tatimi i këtyre fitimeve; ose

b) të tatojë këto fitime duke autorizuar shoqërinë mëmë dhe selinë e përhershme të zbresin nga vlera e tatimit atë pjesë të tatimit të shoqërisë që lidhet me ato fitime dhe që është paguar nga dega e saj dhe nga çdo degë në nivel më të ulët, me kusht që çdo nivel i shoqërisë dhe degët e saj në nivel më të ulët të jenë brenda përkufizimeve të parashikuara në nenin 2 dhe të plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 3, deri në kufirin e shumës që i korrespondon tatimit që duhet paguar.

2. Asgjë në këtë direktivë nuk e pengon shtetin anëtar të shoqërisë mëmë që ta konsiderojë degën si transparente për qëllime tatimore në bazë të vlerësimit nga ky shtet anëtar të karakteristikave ligjore të asaj dege, që rrjedhin nga ligji sipas të cilit ajo është themeluar, dhe për rrjedhojë të tatojë shoqërinë mëmë për pjesën e fitimeve të saj në degë, në momentin kur lindin këto fitime. Në këtë rast shteti anëtar i shoqërisë mëmë shmang tatimin e fitimeve të shpërndara të degës.

Shteti anëtar i shoqërisë mëmë kur vlerëson pjesën e fitimit të shoqërisë mëmë në degën e saj, në momentin që ky fitim lind, duhet ose t'i përjashtojë këto fitime ose të autorizojë shoqërinë mëmë të zbresë nga vlera e tatimit atë pjesë të tatimit të shoqërisë që lidhet me pjesën e fitimit të shoqërisë mëmë dhe që është paguar nga dega e saj dhe nga çdo degë në nivel më të ulët, me kusht që çdo nivel i shoqërisë dhe degët e saj në nivel më të ulët të jenë brenda përkufizimeve të

parashikuara në nenin 2 dhe të plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 3, deri në kufirin e shumës që i korrespondon tatimit që duhet paguar.

3. Çdo shtet anëtar ka mundësinë të parashikojë që ndryshimet lidhur me pjesën e zotëruar dhe çdo humbje që rezulton nga shpërndarja e fitimeve të degës, të mos zbritet nga fitimet e tatueshme të shoqërisë mëmë.

Kur kostot e menaxhimit lidhur me pjesën e zotëruar në këtë rast janë në shkallë fikse, vlera fikse nuk duhet të jetë më e madhe se 5% e fitimeve të shpërndara nga dega.

4. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen deri në datën e hyrjes në fuqi të sistemit të përbashkët të tatimit të shoqërisë.

5. Këshilli duke vepruar unanimisht në përputhje me procedurën e veçantë legislative dhe pasi të konsultohet me Parlamentin Evropian dhe Komitetin Ekonomik dhe Social duhet të miratojë, në një moment të përshtatshëm, rregullat që duhet të zbatohen duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të sistemit të përbashkët të tatimit të shoqërisë.

Neni 5

Fitimet që një degë i shpërndan shoqërisë së saj mëmë përjashtohen nga tatimi në burim.

Neni 6

Shteti anëtar i një shoqërie mëmë nuk mund të vendosë tatim në burim për fitimet që kjo shoqëri arkëton nga dega.

Neni 7

1. Termi "tatim në burim" i përdorur në këtë direktivë nuk mbulon pagesën paraprake ose parapagimin (précompte) e tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë të shteti anëtar i degës, që është bërë në lidhje me shpërndarjen e fitimeve të shoqëria e saj mëmë.

2. Kjo direktivë nuk cenon zbatimin e dispozitave vendase ose atyre të parashikuara në marrëveshje që synojnë eliminimin ose uljen e tatimit të dyfishtë të dividendëve, sidomos dispozitat që kanë të bëjnë me pagesën e kreditimeve të tatimit të përfituesit të dividendëve.

Neni 8

1. Shtetet anëtare duhet të miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme administrative për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë deri më 18 janar 2012. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyrat për bërjen e një reference të tillë përcaktohen nga vetë shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit të brendshëm që ato miratojnë në fushën që mbulohet nga kjo direktivë së bashku me tabelën e përputhshmërisë midis tyre dhe kësaj direktive.

Neni 9

Direktiva 90/435/KEE e ndryshuar nga aktet e renditura në shtojcën II, pjesa A, shfuqizohet pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm të direktivave të përcaktuara në shtojcën II, pjesa B.

Referimet ndaj direktivës së shfuqizuar interpretohen si referime ndaj kësaj direktive dhe shpjegohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë në shtojcën III.

Neni 10

Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 11

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 30 nëntor 2011.

Për Këshillin

Presidenti

J. VINCENT-ROSTOWSKI

SHTOJCA I

PJESA A

Lista e shoqërive të përmendura në nenin 2, germa "a", pika I

a) shoqëritë e themeluara në bazë të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 2157/2001, datë 8 tetor 2001, "Për statutin e një shoqërie evropiane (SE)"⁶ dhe Direktivës së Këshillit 2001/86/KE, datë 8 tetor 2001, që shton edhe përfshirjen e punëmarrësve statutin e shoqërive evropiane⁷ dhe shoqëritë kooperative të themeluara sipas Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1435/2003, datë 22 korrik 2003, "Për statutin e shoqërive kooperative evropiane (SKE)"⁸ dhe Direktivës së Këshillit 2003/72/KE, datë 22 korrik 2003, që shton edhe përfshirjen e punëmarrësve në statutin e shoqërive kooperative evropiane⁴;

b) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit belg, të njohura si "société anonyme"/"naamloze vennootschap", "société en commandite par actions"/"commanditaire vennootschap op aandelen", "société privée à responsabilité limitée"/"besloten vennootschap met beperkte aansprakelijkheid", "société coopérative à responsabilité limitée"/"coöperatieve

vennootschap met beperkte aansprakelijkheid", "société coopérative à responsabilité illimitée"/"coöperatieve vennootschap met onbeperkte aansprakelijkheid", "société en nom collectif"/"vennootschap onder firma", "société en commandite simple"/"gewone commanditaire vennootschap", sipërmarrjet publike që janë përshtatur sipas njëres nga format ligjore të mësipërme, dhe shoqëritë e tjera të themeluara sipas legjislacionit belg e që i nënshtrohen tatimit mbi shoqërinë në Belgjikë;

c) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit bullgar, të njohura si: "събирателно дружество", "командитно дружество", "дружество с ограничена отговорност", "акционерно дружество", "командитно дружество с акции", "неперсонифицирано дружество", "кооперации", "кооперативни съюзи", "държавни предприятия", të themeluara sipas legjislacionit bullgar dhe që kryejnë veprimtari tregtare;

d) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit çek, të njohura si: "akciová společnost", "společnost s ručením omezeným";

e) shoqëritë e themeluara sipas ligjit danez, të njohura si "aktieselskab" dhe "anpartsselskab". Shoqëri të tjera që i nënshtrohen tatimit, sipas Ligjit për tatimin mbi shoqërinë, për sa kohë që tatimi mbi të ardhurat e tyre llogaritet dhe tatohet në përputhje me legjislacionin e përgjithshëm tatimor, të zbatueshëm për "aktieselskaber";

f) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit gjerman, të njohura si "Aktiengesellschaft", "Kommanditgesellschaft auf Aktien", "Gesellschaft mit beschränkter Haftung", "Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit", "Erwerbs- und Wirtschaftsgenossenschaft", "Betriebe gewerblicher Art von juristischen Personen des öffentlichen Rechts", dhe shoqëri të tjera, të themeluara sipas legjislacionit gjerman e që i nënshtrohen tatimit mbi shoqërinë në Gjermani;

g) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit estonez, të njohura si: "täisühing", "usaldusühing", "osühing", "aktsiaselts", "tulundusühistu";

h) shoqëritë e themeluara ose që ekzistojnë sipas legjislacionit irlandez, organet e regjistruara sipas Ligjit për shoqëritë industriale dhe shoqëritë e kursimit, shoqëritë e ndërtimit të themeluara sipas ligjeve për shoqëritë e ndërtimit dhe bankat e kursimit me kujdestari, në kuptim të ligjit për bankat e kursimit me kujdestari, të vitit 1989;

i) shoqëritë sipas legjislacionit grek që njihen si 'ανώνυμη εταιρεία', 'εταιρεία περιορισμένης ευθύνης (Ε.Π.Ε.)' dhe shoqëri të tjera të themeluara sipas ligjit grek e që i nënshtrohen tatimit mbi shoqërinë në Greqi;

j) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit spanjoll, të njohura si: "sociedad anónima", "sociedad comanditaria por acciones", "sociedad de responsabilidad limitada", organet sipas të drejtës publike që operojnë sipas së drejtës private. Subjekte të tjera të themeluara sipas legjislacionit spanjoll e që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë në Spanjë ("Impuesto sobre Sociedades");

k) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit francez, të njohura si "société anonyme", "société en commandite par actions", "société à responsabilité limitée", "sociétés par actions

simplifiées", "sociétés d'assurances mutuelles", "caisses d'épargne et de prévoyance", "sociétés civiles", të cilat i nënshtrohen automatikisht tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë, "coopératives", "unions de coopératives", sipërmarrjet dhe subjektet publike tregtare dhe industriale, si dhe shoqëri të tjera të themeluara sipas legjislacionit francez e që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë në Francë;

l) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit italian, të njohura si "società per azioni", "società in accomandita per azioni", "società a responsabilità limitata", "società cooperative", "società di mutua assicurazione", dhe subjektet private dhe publike me veprimtari kryesisht ose tërësisht tregtare;

m) sipas legjislacionit qipriot: "εταιρείες" sipas përkufizimit në ligjet për tatimin mbi të ardhurat;

n) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit letonez, të njohura si: "akciju sabiedrība", "sabiedrība ar ierobežotu atbildību";

o) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit lituanez;

p) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit të Luksemburgut, të njohura si "société anonyme", "société en commandite par actions", "société à responsabilité limitée", "société coopérative", "société coopérative organisée comme une société anonyme", "association d'assurances mutuelles", "association d'épargne-pension", "entreprise de nature commerciale, industrielle ou minière de l'État, des communes, des syndicats de communes, des établissements publics et des autres personnes morales de droit public", si dhe shoqëri të tjera të themeluara sipas legjislacionit të Luksemburgut dhe që i nënshtrohen tatimit mbi shoqërinë në Luksemburg;

q) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit hungarez, të njohura si: "közkereseti társaság", "betéti társaság", "közös vállalat", "korlátolt felelősségű társaság", "részvénytársaság", "egyesülés", "szövetkezet";

r) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit maltez, të njohura si: "Kumpaniji ta' Responsabilita' Limitata", "Soċjetajiet en commandite li l-kapital tagħhom maqsum f'azzjonijiet";

s) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit holandez, të njohura si "naamloze vennootschap", "besloten vennootschap met beperkte aansprakelijkheid", "pen commanditaire vennootschap", "coöperatie", "onderlinge waarborgmaatschappij", "fonds voor gemene rekening", "vereniging op coöperatieve grondslag", "vereniging welke op onderlinge grondslag als verzekeraar of kredietinstelling optreedt", si dhe shoqëri të tjera të themeluara sipas legjislacionit holandez e që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë në Holandë;

t) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit austriak, të njohura si "Aktiengesellschaft", "Gesellschaft mit beschränkter Haftung", "Versicherungsvereine auf Gegenseitigkeit", "Erwerbs- und Wirtschaftsgenossenschaften", "Betriebe gewerblicher Art von Körperschaften des öffentlichen Rechts", "Sparkassen", dhe shoqëri të tjera të themeluara sipas legjislacionit austriak e që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e shoqërisë në Austri;

u) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit polak, të njohura si: "spółka akcyjna", "spółka z ograniczoną odpowiedzialnością";

v) shoqëritë tregtare ose shoqëritë e të drejtës civile që kanë formë tregtare si dhe kooperativat dhe sipërmarrjet publike të themeluara në përputhje me legjislacionin portugez;

w) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit rumun, të njohura si: "societăți pe acțiuni", "societăți în comandită pe acțiuni", "societăți cu răspundere limitată";

x) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit sloven, të njohura si: "delniška družba", "komanditna družba", "družba z omejeno odgovornostjo";

y) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit sllovak, të njohura si: "akciová spoločnosť", "spoločnosť s ručením obmedzeným", "komanditná spoločnosť";

z) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit finlandez, të njohura si "osakeyhtiö"/"aktiebolag", "osuuskunta"/"andelslag", "säästöpankki"/"sparbank" dhe "vakuutusyhtiö"/"försäkringsbolag";

(aa) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit suedez, të njohura si "aktiebolag", "försäkringsaktiebolag", "ekonomiska föreningar", "sparbanker", "ömsesidiga försäkringsbolag", "försäkringsföreningar";

(ab) shoqëritë e themeluara sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar.

PJESA B

Lista e taksave të përmendura në nenin 2, germa "a", pika III

— impôt des sociétés/vennootschapsbelasting në Belgjikë,

— корпоративен данък në Bullgari,

— daň z příjmů právnických osob në Republikën Çeke,

— selskabsskat në Danimarkë,

— Körperschaftssteuer në Gjermani,

— tulumaks në Estoni,

— tatim shoqërie në Irlandë,

— φόρος εισοδήματος νομικών προσώπων κερδοσκοπικού χαρακτήρα në Greqi,

— impuesto sobre sociedades në Spanjë,

— impôt sur les sociétés në Francë,

- imposta sul reddito delle società në Itali,
- φόρος εισοδήματος në Qipro,
- uzņēmumu ienākuma nodoklis në Letoni,
- pelno mokestis në Lituani,
- impôt sur le revenu des collectivités në Luksemburg,
- társasági adó, osztalékadó në Hungari,
- taxxa fuq l-income në Maltë,
- vennootschapsbelasting në Holandë,
- Körperschaftssteuer në Austri,
- podatek dochodowy od osób prawnych në Poloni,
- imposto sobre o rendimento das pessoas colectivas në Portugali,
- impozit pe profit në Rumani,
- davek od dobička pravnih oseb në Slloveni,
- daň z príjmov právnických osôb në Sllovaki,
- yhteisöjen tulovero/inkomstskatten för samfund në Finlandë,
- statlig inkomstskatt në Suedi,
- tatim shoqërie në Mbretërinë e Bashkuar.

SHTOJCA II

PJESA A

Direktiva e shfuqizuar me listën e ndryshimeve vijuese

(përmendur në nenin 9)

Direktiva e Këshillit 90/435/KEE <i>(Gazeta Zyrtare L 225, 20.8.1990, f. 6).</i>	
Pika XI.B.I.3 e shtojcës I në Aktin e Aderimit, 1994	

<i>(Gazeta Zyrtare L 241, 29.8.1994, f. 196).</i>	
Direktiva e Këshillit 2003/123/KE <i>(Gazeta Zyrtare L 7, 13.1.2004, f. 41).</i>	
Pika 9.8.A e shtojcës II në Aktin e Aderimit, 2003 <i>(Gazeta Zyrtare L 236, 23.9.2003, f. 555).</i>	
Direktiva e Këshillit 2006/98/KE <i>(Gazeta Zyrtare L 363, 20.12.2006, f. 129).</i>	Shtojca, vetëm pika 7

PJESA B

Lista e afateve kohore për transpozim në legjislacionin e brendshëm

(përmendur në nenin 9)

Direktiva	Afati për transpozim
90/435/KEE	31 dhjetor 1991
2003/123/KE	1 janar 2005
2006/98/KE	1 janar 2007

SHTOJCA III

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Direktiva 90/435/KEE	Kjo direktivë
Neni 1, paragrafi 1, ndarja e parë deri në ndarjen e katërt	Neni 1, paragrafi 1, germat "a" deri në "d"
Neni 1, paragrafi 2	Neni 1, paragrafi 2
Neni 2, paragrafi 1, pjesa e parë e fjalisë hyrëse	Neni 2, fjalia hyrëse
Neni 2, paragrafi 1, pjesa e dytë e fjalisë hyrëse	Neni 2, germa "a", fjalia hyrëse

Neni 2, paragrafi 1, germa "a"	Neni 2, germa "a", pika I
Neni 2, paragrafi 1, germa "b"	Neni 2, germa "a", pika II
Neni 2, paragrafi 1, germa "c", fjalia hyrëse e nënparagrafit të parë dhe nënparagrafit të dytë	Neni 2, germa "a", pika III
Neni 2, paragrafi 1, germa "c", nënparagrafi i parë, ndarja e parë deri në ndarjen e njëzet e shtatë	Shtojca I, Pjesa B, ndarja e parë deri në ndarjen e njëzet e shtatë
Neni 2, paragrafi 2	Neni 2, germa "b"
Neni 3, paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 3 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 3, paragrafi 1, germa "a", nënparagrafi i parë, fjalët e para	Neni 3, paragrafi 1, germa "a", fjalia hyrëse
Neni 3, paragrafi 1, germa "a", nënparagrafi i parë, fjalët e fundit	Neni 3, paragrafi 1, germa "a", pika I
Neni 3, paragrafi 1, germa "a", nënparagrafi i dytë	Neni 3, paragrafi 1, germa "a", pika II
Neni 3, paragrafi 1, germa "a", nënparagrafi i tretë	—
Neni 3, paragrafi 1, germa "a", nënparagrafi i katërt	—
Neni 3, paragrafi 1, germa "b"	Neni 3, paragrafi 1, germa "b"
Neni 3, paragrafi 2, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 3, paragrafi 2, germat "a" dhe "b"
Neni 4, paragrafi 1, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 4, paragrafi 1, germat "a" dhe "b"
Neni 4, paragrafi 1a	Neni 4, paragrafi 2
Neni 4, paragrafi 2, fjalia e parë	Neni 4, paragrafi 3, nënparagrafi i parë
Neni 4, paragrafi 2, fjalia e dytë	Neni 4, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë
Neni 4, paragrafi 3, nënparagrafi i parë	Neni 4, paragrafi 4
Neni 4, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë	Neni 4, paragrafi 5
Nenet 5, 6 dhe 7	Nenet 5, 6 dhe 7

Neni 8, paragrafi 1	—
Neni 8, paragrafi 2	Neni 8
—	Neni 9
—	Neni 10
Neni 9	Neni 11
Shtojca	Shtojca I, Pjesa A:
—	Shtojca II
—	Shtojca III

-
1. Opinioni i dërguar më 4 maj 2011 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).
 2. *Gazeta Zyrtare C 107, 6.4.2011, f. 73.*
 3. *Gazeta Zyrtare L 225, 20.8.1990, f. 6.*
 4. Shih shtojcën II, pjesa A.
 5. [2008] ECR I-03189.
 6. *Gazeta Zyrtare L 294, 10.11.2001, f. 1.*
 7. *Gazeta Zyrtare L 294, 10.11.2001, f. 22.*
 8. *Gazeta Zyrtare L 207, 18.8.2003, f. 1.*
 9. *Gazeta Zyrtare L 207, 18.8.2003, f. 25.*
-